

FJALA E DEPUTETIT LUÇIANO BOÇI

Atëherë, të nderuar deputetë,

Drejtësia amerikane ka vendosur nën hetim Kryeministrin Edi Rama dhe bashkëpunëtorët e tij të ngushtë për përpjekjen e tyre të financimit me para në dorë dhe të financimit me interesa milionëshe, për të ekzekutuar, për të eliminuar opozitën e vendit, e shkruar e zeza mbi të bardhë në aktin e “Grand Jury”-së. Të mos harrojmë se nuk jeni të vetëm dhe rastësisht, Kryeministri me bashkëpunëtorët e tij, sepse ju keni bërë titur dhe keni ulëritur për hapjen e dosjeve, ndërkohë që aktivizoni atavizmat e ish-Sigurimit të Shtetit për të goditur pikërisht opozitën. Por nuk është vetëm dora e zgjatur ajo që ka goditur opozitën, dora kryesore që godet sot opozitën është vetë Kryeministri, i investuar në çdo qelizë të korrupsionit të shoqërisë shqiptare. Ai ka korrupsionuar ekonominë, mediet, parlamentin dhe çdo gjë tjetër në Shqipëri. Kaloi edhe oqeanin për të korrupsionuar SHBA, vetëm e vetëm që të realizonte ëndrrën e tij: eliminimin e opozitës, me qëllimin për të sunduar nën një regjim putinist, duke thënë vetë: “Gjithmonë jam një hap përpara”. Ku? Në korrupsion? Po! Dhe cilin korrupsion ky Kryeministër? Zimbabvenë? Burundin? Malin e Zi? Maqedoninë e Veriut? Jo, korrupsion SHBA, duke goditur imazhin e sigurisë së shtetit kryesor që ruan ekuilibrat botërorë; godet zemrën e demokracisë. Ky njeri sot mungon, fshihet, ka frikë të japë llogari, prandaj duhet t’i nënshtrohet një mocioni me debat, ku secili deputet duhet të japë mendimin e tij. Ju, po deshët, mbrojeni, po deshët, lëshojeni! Ne do të bëjmë zbulimin e së vërtetës, asaj të vërtetë që sot institucionet e drejtësisë amerikane e kanë iniciuar dhe do të vazhdojnë hetimet.

Drejtësia shqiptare, ajo e kapura prej jush, duhej të vepronte menjëherë duke e marrë Kryeministrin të pandehur. Pse vonon drejtësia shqiptare? Jemi para një veprë penale shumë të rëndë, të disa veprave penale, duke përfshirë këtu (se ju vjen për të qeshur) tradhtinë kombëtare. Doni të qeshni më shumë? E dini se cila është deklarata qesharake e këtij Kryeministri? “Ato para, 225 mijë dollarë, ishin borxh që McGonigal ia kishte marrë Agron Nezës, sigurimisit.” A e kuptoni? Ky është garanti i borxhit, se ku i di ky këto muhabete me imtësi? Një drejtësi të drejtë do t’i mjaftonte ky fakt për të nisur hetimet. E ka thënë sapo doli nga selia e PS-së. Hapeni videon! Më lini kohë që ta nxjerr këtu. Çuditërisht që nuk keni dijeni! (Ndërhyrje nga salla pa mikrofon) Po, qeshni, se në të vërtetë është për të qeshur. Të vijë vetë e të japë llogari për të gjithë këtë lloj aktiviteti të iniciuar, të organizuar dhe me dëshirën e tij për ta finalizuar. Po, është e vërtetë që Shqipërinë e krijuan idealistët; e shpëtoi rastësia ose Zoti, por po e shkatërrojnë politikanët; jo këta këtu, këta politikanët këtej dhe jo ju këtu... E kam majtas, është ai aty. Ky mallkim po na ndjek brez pas brezi, sepse njerëzit e zgjedhur në krye, si ky kryeministër sot, kanë damkën e tradhtarit të kombit. Mos u fshihni! Është fjalë e rëndë, ka peshë të rëndë, por e ka bërë aktin e tradhtisë, sepse ka goditur interesat e Shqipërisë, votuesit shqiptarë, sistemin politik shqiptar dhe demokracinë amerikane. Ai njeri duhet të vijë me urgjencë. Nuk mund të kalojë vetëm me një interpelancë.

Unë besoj te sinqeriteti i kolegëve të mi. E di shqetësimin e tyre. Kryeministri nuk mund ta përdorë interpelancën si lumin Jordan për të fshehur dhe për të larë mëkatet e tij. Jo, çdo deputet të vijë këtu dhe ta vërë përballë me shpatulla pas murit, sepse ai sot është kriminel më i madh që ka nxjerrë historia e Shqipërisë. Donit ta fshihnit dhe ai donte të hynte në histori? Ja, edhe dëshira iu plotësua.

Edi Rama ka hyrë në histori si tradhtari më i madh i kombit shqiptar! Prandaj, ne kërkojmë me insistim që mocioni me debat të nisë menjëherë, me praninë e Kryeministrit dhe të mos harxhojmë asnjë minutë më shumë. Interesi i publikut shqiptar, interesi i faktorit ndërkombëtar, interesi i të gjithë miqve të Shqipërisë është sot te ky debat, sepse Kryeministri jo vetëm ka cenuar sigurinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, jo vetëm ka cenuar Shqipërinë, por ka hedhur në erë besueshmërinë e institucioneve ndërkombëtare te politika shqiptare. A e mendoni se si mund të paraqitemi ne në konferencën e NATO-s? Kush do të shkojë? Ky Kryeministër, që ka goditur sigurinë e shtetit drejtues të Aleancës së Atlantikut?!